

VENDIM
Nr. 153, datë 19.3.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SHËTITORES NË ORIKUM,
FAZA II, TË BASHKISË ORIKUM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimi i shëtitores në Orikum, faza II, në bashkinë Orikum, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë Orikum.

3. Vlera e shpërblimit, për sipërfaqen 65.2 (gjashtëdhjetë e pesë pikë dy) m², truall, në masën 7 781 000 (shtatë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë) lekë, të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Orikut, miratuar në buxhetin e vitit 2014.

4. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas miratimit të projektit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Orikut.

6. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 65.2 (gjashtëdhjetë e pesë pikë dy) m² truall, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit “Ndërtimi i shëtitores në Orikum, faza II”, në bashkinë Orikum, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe bashkia e Orikut për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PERSONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN
PËR “NDËRTIMI I SHËTITORES ORIKUM, FAZA E II- TË”

Emër, mbiemër	Sip në m ²	Çmimi/lekë	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit	Zona kadastrale
Përparim Kulluri	65.2 m ²	119 340	7 781 000	Vërtetim pronësie	2832

